



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

26 dhjetor 2013, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA**  
**Komuna e Prizrenit të shtoj aktivitetin për inkasimin e borxheve**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajit dhjetor ka shqyrtuar çështjen e arkëtimit të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2013.

Monitorimi në këtë pikë ka vërtetuar se Komuna e Prizrenit ka vazhduar që edhe këtë vit të ballafaqohet me sfidat e njëjta sikurse vitin e kaluar, çështje këto që ishin identifikuar edhe në Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2012 ([http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPZ\\_2012\\_Shqip\\_9759.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2012_Shqip_9759.pdf)).

Për të gjitha këto çështje janë kërkuar sqarime nga DEF-i, dhe në përgjigjen e ofruar është theksuar se trendi i të hyrave është në rritje e sipër dhe se këshillat e operatorëve privat kanë qenë efikase.

Bazuar në raportin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa (DEF), Komuna e Prizrenit në vitin 2013 ka planifikuar që të inkasoj 6 milionë e 120 mijë euro dhe deri në fund të nëntorit të këtij viti ka inkasuar 3 milionë e 523 mijë euro, respektivisht 2 milionë e 597 milionë euro më pak nga shuma e paraparë. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave vetanake ka qenë 57.5 % gjatë këtyre muajve.

Inkasimi nga Taksat për veprimtari biznese është vetëm 24 për qind, pasi që nga 745 mijë eurot e planifikuara janë inkasuar vetëm rreth 180 mijë euro.

Te Lejet e ndërtimit nga 1.05 milionë euro të planifikuara janë inkasuar vetëm 387 mijë euro, apo rreth 36.8 për qind.

Të hyrat nga pronat e dhëna me qira janë 217 mijë e 500 euro nga 540 mijë të planifikuara, apo vetëm 40 për qind.

Ndërsa të hyrat nga pagesat e tatimit pronë janë 1.27 milionë euro nga 1.37 milionë euro të planifikuara apo afër 93 për qind. Mirëpo ashtu siç kishte identifikuar Auditori, në këtë kategori të hyrash, nuk ka sistem adekuat të regjistrimit të hyrave vjetore, për shkak të shumës së madhe të obligimeve të grumbulluara nga vitet e kaluara që në fund të vitit 2012 arrinte shifrën prej 5.3 milionë eurove.

EC Ma Ndryshe konsideron se Komuna e Prizrenit ende ballafaqohet me sfida të shumta sa i përket inkasimit të hyrave vetanake. Përpjekjet e DEF-it, si vitin e kaluar ashtu edhe këtë vit kanë qenë që me konsulencë, respektivisht zhvillimin e hulumtimeve nga operatorët privatë të gjej zgjidhje për rritjen e inkasimit të mjeteve. Në 2012-ën dhe në 2013-ën DEF ka harxhuar nga 10 mijë euro, për këtë qëllim, mirëpo raportet e realizuara nga hulumtimet ende nuk janë bërë publike.

Sipas këtyre të gjeturave, EC Ma Ndryshe vlerëson se DEF dhe Komuna e Prizrenit duhet të rrisin nivelin e transparencës dhe komunikimit me qytetarët dhe bizneset në mënyrë që ata të ndërgjegjësohen se pagesa e obligimeve ndaj komunës mundëson shërbime më të mira dhe zhvillim të komunës së Prizrenit. Në të kundërtën mos realizimi i borxheve të vjetra që kanë mbetur nga vitet paraprake, siç ka konstatuar Auditori ndikon në zvogëlimin e buxhetit në total, si dhe mosrealizimin e shumë projekteve të planifikuara me vetëfinancim.

Për këto arsye EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Të nis zbatimin e menjëhershëm të 4 rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm në lidhje me veprimet për përmirësimin e inkasimit të hyrave vetanake;
- Në afatin më të shkurtër kohor t'i bëj publike të gjeturat e hulumtimeve të kryera nga operatorët e kontraktuar dhe të organizoj debat me qytetarët e përfaqësuesit e bizneseve në lidhje me këto të gjetura;
- Të shtojë aktivitetin për ta rritur inkasimin e borxheve të mbetura nga vitet paraprake, duke krijuar një mekanizëm të përbashkët me shoqërinë civile për vendosjen e dialogut të vazhdueshëm me qytetarët dhe komunitetin e biznesit për planifikim dhe realizim më të mirë të buxhetit;

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren  
Rr. Perandori Dioklician 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*